

VENDIM
Nr. 206, datë 15.3.2017

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 547, DATË 9.8.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE
NATYRORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

1. Në fund të pikës 3 bëhet shtesa me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“- Kryen, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën teknike për projektet e kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, sipas tarifave të përcaktuara në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me përjashtim të oponencës teknike për punimet e ndërtimit, që kryhet nga institucionet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.”.

II. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

TARIFAT PËR OPONENCËN TEKNIKE PËR PROJEKTET E NDËRTIMIT

TËKAPACITETEVE PRODHUESE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Tarifat për oponencën teknike për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike janë, si më poshtë:

I. Për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike që janë objekt koncesioni në fazën e studimit të fizibilitetit:

a) Deri në 1 MW tarifa e oponencës do të jetë 50 000 lekë.

b) Mbi 1 MW deri në 5 MW, tarifa e oponencës teknike do të jetë 100 000 lekë.

c) Mbi 5 MW deri në 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 300 000 lekë.

ç) Mbi 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 500 000 lekë.

II. Për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike që janë objekt koncesioni në fazën e projektit të zbatimit:

a) Deri në 1 MW tarifa e oponencës do të jetë 100 000 lekë.

b) Mbi 1 deri në 5 MW, tarifa e oponencës teknike do të jetë 200 000 lekë.

c) Mbi 5 deri në 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 500 000 lekë.

ç) Mbi 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 700 000 lekë.

III. Për ndërtimin e objekteve të prodhimit të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni:

a) Deri në 1 MW tarifa e oponencës do të jetë 100 000 lekë.

b) Mbi 1 MW deri në 5 MW, tarifa e oponencës teknike do të jetë 200 000 lekë.

c) Mbi 5 MW deri në 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 500 000 lekë.

ç) Mbi 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 700 000 lekë.